



Strategjia Vendore e Kosovës 2022-2027

Miratuar nga Bordi i Drejtorëve më 26 Janar 2022

PUBLIC



European Bank
for Reconstruction and Development



Përkthimet e tekstit original të dokumentit ofrohen nga BERZH vetëm për lehtësinë e lexuesit. Përderisa BERZH ka bërë kujdes të arsyeshëm për të siguruar vërtetësinë e përkthimit, BERZH nuk garanton apo miraton saktësinë e përkthimit. Mbështetja në çdo përkthim të tillë do të jetë në përgjegjësinë e vetë lexuesit. Në asnjë rrethanë BERZH-i, punonjësit ose agjentët e tij nuk do të jenë përgjegjës ndaj lexuesit ose kujtdo tjetër për çdo pasaktësi, gabim, lëshim, fshirje, defekt dhe/ose çdo ndryshim të çdo përmbajtjeje të përkthimit, pavarësisht nga shkaku ose për ndonjë dëmtim. që rezulton prej saj. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ose kontradikte midis versionit anglisht dhe atij të përkthyer, versioni në anglisht do të mbizotërojë.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive

Kosovë– Foto çasti e BERZH-it

I. Zbatimi i Strategjisë së mëparshme (2016-2020)

Rezultatet kryesore të tranzicionit të arritura gjatë strategjisë së mëparshme

Sfidat e zbatimit dhe mësimet kryesore

II. Konteksti ekonomik

Konteksti makroekonomik dhe perspektiva për periudhën strategjike

Sfidat kryesore të tranzicionit

III. Prioritetet qeveritare dhe angazhimi i akterëve

IV. Caktimi i prioriteteve të Strategjisë së BERZH-it për Kosovën

V. Aktivitetet dhe korniza e rezultateve

VI. Harta e Përplotësimit të Ndërsjellë të Partnerëve Ndërkombëtarë në Zonat e Biznesit të BERZH-it

VII. Rreziqet e zbatimit dhe implikimet mjedisore dhe sociale

VIII. Vlerësimi i bashkëfinancimit nga donatorët

Shtojca 1 - Vlerësimi politik

Fjalorth i termave kryesorë

IVB Investimet vjetore nga Banka

KBV Këshillë për bizneset e vogla

VeV Vendet e veprimit

CSR Përgjegjësia sociale e korporatës

EE Efiçienca e energjisë

BEI Banka Evropiane e Investimeve

NPT Ndikimi i prituri i tranzicionit

EU Bashkimi Evropian

M&S Mjedisore dhe sociale

IHD Investimet e Huaja Direkte

IF Institucion Financiar

LFEGJ Lehtësimi i Financimit të Ekonomisë së Gjellbër

TEGj Tranzicioni i Ekonomisë së Gjellbër

GS Gaz serrë

GVC Zinxhirët e vlerave globale

Sh&S Shëndeti dhe siguria

ICA Industria, tregtia dhe agrobiznesi

ICT Teknologjia informative dhe e komunikimit

IFN Institucion Financiar Ndërkombëtar

IPA Financimi i Para-anëtarësimit

IPPF Lehtësimi i përgatitjes së projekteve infrastrukturore

VLL Valuta lokale

IKM Investim komunal dhe mjedisor

B&B Bashkimet dhe blerjet

P&Sh Prodhimi dhe shërbimet

MSME Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

KPK Kontribut i përcaktuar kombëtarisht

KJP Kreditë joperformuese

IFP Institucion financiar partner

NP Ndërmarrjet publike

PPP Partneritet publiko-privat

NTP Ndikimi i tranzicionit të portofolit

LNR Lehtësimi i ndarjes së riskut

BSh Bankë shtetërore

NSh Ndërmarrje shtetërore

MSA Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

BT Bashkëpunimi Teknik

PLT Programi për lehtësimin e tregtisë

PIKN Programi i Investimit të Kapitalit

Ndërmarrës

BP Ballkani Perëndimor

KIBP Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor

GnB Programi Gratë në Biznes

vpv vit për vit

Përkushtimi i Kosovës ndaj parimeve politike të përcaktuara në nenin 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës dhe zbatimi i tyre ka vazhduar që nga miratimi i strategjisë së mëparshme të vendit, në përputhje me përpjekjet e saj drejt përafrimit me BE-në. Shumë sfida mbesin në të njëjtën kohë. Kosova ka shumë dobësi kryesore institucionale të përbashkëta për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë sundimin e dobët të ligjit, kapacitetin relativisht të ulët të administratës publike dhe një kulturë të pabarabartë të dialogut dhe ndërtimit të konsensusit politik. Këto përkeqësohen më tutje nga marrëdhëniet e ndërlikuara ndëretnike brenda vendit dhe kundërthëniet e vazhdueshme politike në bashkësinë e gjerë ndërkombëtare përkitazi me statusin e Kosovës.

Si një ekonomi e hapur dhe rinore që gjendet në zemër të Ballkanit Perëndimor dhe në udhëkryqet kryesore të korridoreve të infrastrukturës rajonale, Kosova është e pozicionuar mirë për ta tejkaluar vendndodhjen pa dalje në det dhe madhësinë e vogël të ekonomisë së saj përmes integritit më të thellë rajonal. Megjithatë, do të nevojiten reforma të ngutshme për ta krijuar një mjedis në të cilin sektori privat mund të lulëzojë përtej tregut të kufizuar vendas dhe për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë. Boshllëqet e tranzicionit janë veçanërisht të theksuara në aspektin e aftësisë konkurruese (me një ekonomi që karakterizohet nga joformaliteti, shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht në mesin e rinjve, dhe boshllëqet gjinore të konsiderueshme), energjisë së gjelbër (me një varësi jashtëzakonisht të madhe nga qymyri, intensitet të lartë të energjisë, mungesë të infrastrukturës komunale dhe mjedisore dhe mosefikasitet të burimeve të tjera) dhe integritit (me zbatim të ngadaltë të projekteve kryesore të konektivitetit të transportit dhe energjisë si dhe nivele joadekuate të aranzhimeve institucionale për tregti dhe investime në nivel rajonal).

BERZH-i është e pozicionuar mirë për të ndihmuar në forcimin e performancës së sektorit privat në vend, përsheptimin e përpjekjeve për reforma për vende cilësore të punës për popullatën e re dhe shumetnike të Kosovës, inkurajimin e pjesëmarrjes së grave dhe rritjen e 'gjelbër' të Kosovës, duke e mundur largimin nga qymyri dhe trajtimin e ndotjes së ajrit, përmes instrumentet të përshtatura të politikave dhe atyre financiare. Banka do të vazhdojë ta përdorë "shkathtësinë" e saj tradicionale të ofrimit të ndihmës për ta zbatuar agjendën e konektivitetit për vend me përqendrim të shtuar në zbatimin e projekteve, do ta shtojë mbështetjen e saj për komunat dhe do t'i evidentojë ato për të realizuar investime në infrastrukturës rezistente ndaj klimës dhe më të gjelbra. Banka do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përsheptimit të zbatimit të investimeve të sektorit publik dhe mbështetjes së realizimit të tyre sipas Planit Ekonomik dhe të Investimeve të BE-së.

Duke e plotësuar agjendën pesëvjeçare, afatgjate të saj, Banka po ashtu do t'i ndihmojë vendit që të përballë me pasojat e pandemisë COVID-19 përmes masave të përsheptuara të reagimit, përfshirë për ndërmarrjet publike dhe komunat si dhe për sektorin financiar, si shtyllë kurizore për veprimtarinë ekonomike. Gjatë tërë kohës, integrimi rajonal do të mbetet yll orientues për t'i orientuar investimet dhe politikat e Bankës, ndërsa theks i veçantë do të vihet në hulumtimin e sinergjive me aktivitetet e Bankës në ekonominë fqinje. Partneriteti i vazhdueshëm strategjik me BE-në dhe IFN-të e tjera dhe mbështetja e donatorëve në formën e ndihmës teknike, granteve për investim dhe garancive që mund të kombinohen me gamën e produkteve të BERZH-it do të jenë qenësore që Banka t'i realizojë prioritetet strategjike në vijim në Kosovë gjatë periudhës 2022-2027:

- Ta krijojë një sektor privat më **konkurrues** dhe më **përfshirës** për ta nxitur rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike;
- Ta mbështesë tranzicionin në ekonomi **të gjelbër** në Kosovë përmes një kombinimi më të qëndrueshëm të energjisë dhe eficiencës më të madhe të resurseve;
- Ta forcojë integrimin rajonal, konektivitetin dhe investimet e huaja.

Kosova – Foto çasti e BERZH-it




European Bank
for Reconstruction and Development


Aktivitetet e Investimeve të BERZH-it në Kosovë (që nga maji i vitit 2021)

Portofoli	350 milion €	Projektet aktive	41
Përqindja e kapitalit	3%	Asetet operative	159 milion €
Përqindja e sektorit privat ¹	61%	Investimi kum. neto	545 milion €


IVB-të dhe Operacionet



Dinamika e portofolit



Përbërja e portofolit



Boshllëqet e tranzicionit²



Shifrat e kontekstit të Kosovës

	Kosovë	Krahasuesit
Popullsia (milion) ³ (2020)	1.8	BH (3.3) Maqedonia e Veriut (2.1) Serbia (6.9)
BPV për kokë banori (PPP, USD) ³ (2020)	11 470	BH (15 231) Maqedonia e Veriut (16,770) Serbia (19,168)
Dendësia e bizneseve të reja ⁴ (regjistrime të reja për 1000 banorë, 2018)	4.0	BH (1.1) Maqedonia e Veriut (3.6) Serbia (1.9)
Papunësia (%), ⁵ (2020)	26.2	BH (15.9) Maqedonia e Veriut (17.2) Serbia (9)
Papunësia e të rinjve ⁴ (2020)	49.7	BH (36.6) Maqedonia e Veriut (37) Serbia (26.6)
Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore (%), ⁴ (2020)	17.8	BH (36.7) Maqedonia e Veriut (41.8) Serbia (46.5)
Intensiteti i energjisë (TFEP/BPV) ⁵ (2019)	0.4	BH (0.4) Maqedonia e Veriut (0.3) Serbia (0.3)
Intensiteti i emetimit/BPV (kgCO2 / 10 '\$) ⁵ (2020)	1.3	BH (1.2) Maqedonia e Veriut (0.7) Serbia (1.0)

1 Investimi kumulativ i Bankës: 5 Baza rikthyese pesëvjeçare në portofol.

2 Cf. Raporti i Tranzicionit i BERZH-it 2021-2022. 3 PEB e FMN-së 4 BB Ndërmarrësia. 5 TZHB të BB-së 6 IEA.

1. Zbatimi i Strategjisë së mëparshme (2016-2021)


1.1. Rezultatet kryesore të tranzicionit të arritura gjatë strategjisë së mëparshme




European Bank
for Reconstruction and Development

Përshtatja strategjike 2016-2021


Investimet vjetore të biznesit (IVB-të)



Asistenca teknike dhe grantet për investim



Performanca e ndikimit të tranzicionit*



Prioriteti 1: Ta mbështesë zhvillimin konkurrues të sektorit privat përmes investimeve, duke e rritur kapacitetin e brendshëm të kompanive dhe duke e përmirësuar mjedisin për biznes

Rezultatet kryesore sasiore

Indikatorët e rezultateve	2020	Që nga viti 2016
Nr. i klientëve të ASB që raportojnë rritje të produktivitetit	30	144
Vëllimi i kredive të disbursuara për MSME	29 m €	299 milion €
Vëllimi i kredive të disbursuara për GnB [m €]	1,2€	12,9€

Rezultatet kryesore të tranzicionit

- E ka lehtësuar qasjen në financa për bizneset e vogla përmes linjave të kredive që i tejkalojnë 50 milion € me 7 banka dhe institucione mikrofinancuese partnere, dhe e ka nënshkruar linjën e parë të qiradhënies.
- E ka mbështetur avancimin e konkurrencës dhe efikasitetit të NVM-ve duke ofruar 186 projekte lokale për konsulencë dhe projekte këshilluese ndërkombëtare, së bashku me trajnimet për stërvitje dhe bartje të shkathtësie.
- E ka mbështetur zgjerimin e sektorit privat përmes kredive direkte (30 milion €) për një gamë të gjerë të kompanive duke ua mundësuar Santefarmës (farmaceutikë), REKS-it (riciklim) dhe Kujtesës (TIK) që t'i zgjerojnë dhe përmirësojnë objektet e tyre.
- E ka lansuar programin "Gratë në Biznes (GnB)" në Kosovë për t'i mbështetur NVM-të që udhëhiqen nga gratë duke ofruar linja të kredive të dedikuara dhe shërbime këshilluese përmes Bankës TEB.
- E ka mbështetur industrinë e agrobiznesit përmes kredive direkte (p.sh. Viva Fresh dhe Meridian) dhe shërbimeve këshilluese për t'u ndihmuar më shumë se 40 bizneseve që të zgjerohen, t'i përmirësojnë zinxhirët e tyre të vlerës, t'i zhvillojnë standardet e tyre dhe t'i analizojnë nevojat e tregut për ta përsheptuar eksportin.
- E ka mbështetur me sukses Bankën Qendrore të Kosovës në miratimin e kornizës ligjore dhe rregullative për faktorizim dhe e ka rishikuar kornizën ligjore që i rregullon bankat në Kosovë, duke e përshtatur atë me praktikën më të mira ndërkombëtare; së bashku me ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin për palët e interesuara, siç janë IFP-të në secilën temë.

* Performanca e ndikimit në tranzicion pasqyron se sa kanë të ngjarë projektet që ta arrijnë ndikimin e tranzicionit që pritet prej tyre me rastin e nënshkrimit. E llogaritur duke u bazuar në portofolin aktiv të pjekur (> 2 vjet).


1. Zbatimi i Strategjisë së mëparshme (2016-2021)

1.1. Rezultatet kryesore të tranzicionit të arritura gjatë strategjisë së mëparshme



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 2: Ta shtojë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e energjisë duke i financuar investimet dhe duke i mbështetur reformat në këtë sektor, si dhe duke promovuar eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme



Rezultatet kryesore të tranzicionit

- I ka drejtuar përpjekjet për të zhvendosur konsumin e Kosovës nga burimet me energji intensive në burimet e ripërtëritshme duke i financuar dy projektet e para të mëdha për burimet e ripërtëritshme: Fermë me erë në Bajgorë, ferma më e madhe e erës në vend (58 milion €), dhe era KITKA (18 milion €) duke e zvogëluar ndotjen dhe ndërprerjet e energjisë.
- U ka ofruar shërbime këshillimore autoriteteve për ta zhvilluar me sukses një kornizë bankare, përfshirë marrëveshjen për blerje të energjisë, për t'i zhblokuar investimet në gjenerimin e ripërtëritshëm në vend.
- E ka përmirësuar eficiencën e energjisë dhe teknologjive të gjelbra në të gjithë sektorët, duke dedikuar linja të kredive përmes IFP-ve dhe dy IMF-ve për t'i dhënë për sektorit të banimit për investime në eficiencën e energjisë; si dhe ua ka mundësuar NVM-ve që të avancojnë objektet e prodhimit dhe ta përmirësuar mbrojtjen e mjedisit.
- I ka trajnuar 295 zyrtarë të kredisë në kredithënie për banim dhe biznes në 3 banka (TEB, AFK, KRK), ndërsa 16 koordinatorëve për EE/BR u është ofruar trajnimin në punë (në kuadër të KOSEP).
- E ka financuar drejtpërsëdrejti qendrën e parë të riciklimit të plastikës në Kosovë (REKS) 6 mil. €) dhe ua ka ofruar këshilla biznesi NVM-ve për ta përmirësuar eficiencën e energjisë dhe menaxhimin e mjedisit.
- E ka lansuar Planin e Veprimit të Qyteteve të Gjelbra për Prishtinën për ta mbështetur këtë qytet që të ketë një qasje sistematike për t'i adresuar sfidat kryesore mjedisore dhe urbane e tij, përfshirë ndotjen e ajrit.

Prioriteti 3: Ta mbështesë konektivitetin dhe integrimin rajonal

Rehabilitimi i Rugës Hekurudhore 10



Rezultatet kryesore të tranzicionit

- E ka mbështetur zgjerimin dhe rehabilitimin e lidhjeve të transportit duke e financuar rehabilitimin e linjës së vetme hekurudhore ndërkombëtare të Kosovës (Ruga Hekurudhore 10) që e lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, të bashkëfinancuar me grantin e BE-KIBP-së, dhe duke e financuar ndërtimin e ë autostradës Kijevë-Zahaq (71 mil. €).
- Ka ofruar shërbime gjithëpërfshirëse këshilluese për ta forcuar zhvillimin e kapaciteteve të autoriteteve për menaxhim të sigurisë rrugore si dhe e ka mbështetur hartimin e legjislacionit/certifikimit të auditimit të sigurisë rrugore.
- I ka mbështetur eksportuesit dhe tregtinë përmes Programit të Lehtësimit të Tregtisë (PLT) të BERZH-it, duke nënshkruar gjashtë linja me dy IFP (NLB Prishtina, dhe Raiffeisen Bank Kosova), dhe duke ristrukturuar me sukses PLT-në me Bankën për Biznes. Përmes këtyre linjave të PLT-së, IFP-të kanë financoi transaksione në vlerë prej më shumë se 8 milion €.
- E ka zhvilluar kapacitetin e IFP-ve duke organizuar trajnime me Shoqatën e Bankave të Kosovës në lehtësimin e tregtisë dhe faktorizimin për bankat lokale.

1. Zbatimi i Strategjisë së mëparshme (2016-2021)



European Bank
for Reconstruction and Development

1.2. Sfidat e zbatimit dhe mësimet kryesore

Konteksti për zbatim

Edhe pse shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 shënoi agimin e një epoke të re, pjesëmarrja e këtij kombi të ri në tregtinë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar është ende e pabarabartë për shkak të çështjeve të pazgjidhura me Serbinë dhe ndasive në bashkësinë e gjerë ndërkombëtare lidhur me statusin e saj. Si një ekonomi e vogël e hapur që gjendet në udhëkryqet kryesore të korridoreve të infrastrukturës rajonale, Kosova është e përgatitur në mënyrë unike për ta tejkaluar vendndodhjen e saj pa dalje në det. Megjithatë, këto çështje të pazgjidhura dhe marrëdhëniet e ndërlikuara ndëretnike i kanë shtuar dobësitë kryesore institucionale, siç është sundimi i dobët i ligjit dhe kapaciteti i ulët i administratës publike. Çështja më e ngutshme e Kosovës qëndron në tranzicionin drejt një modeli të qëndrueshëm të rritjes ekonomike, ku sektori privat mund të lulëzojë dhe që ofron punë cilësore për rininë e saj të konsiderueshme.

Kosova u bë vend i operacioneve në vitin 2012, çfarë ia mundësoi Bankës që ta shtojë ndjeshëm angazhimin në sektorin privat, por edhe që për herë të parë të fillojë t'i trajtojë sfidave e mëdha infrastrukturore, duke përfshirë agjendën e konektivitetit të transportit të vendit. Gjatë periudhës së strategjisë së kaluar të vendit, dhe në përputhje me agjendën e gjelbër të saj, BERZH i ka diversifikuar përpjekjet për ta mbështetur tranzicionin e Kosovës drejt një kombinimi më të qëndrueshëm të energjisë dhe e ka shtuar angazhimin me komunat. Këto përpjekje janë reflektuar në rritjen e shifrave të IVB-ve, duke arritur një rekord në vitin 2019, të plotësuar me nivelet në rritje të disbursimeve.

Sfidat e zbatimit

- Mungesa e mundësive bankare për financim të drejtpërdrejtë në sektorin e korporatave dhe të NVM-ve si rezultat i kapacitetit të ulët për të hartuar projekte të bankueshme, informaliteti, posaçërisht në praktikën e kontabilitetit, qeverisja e dobët e korporatave dhe cilësia e menaxhimit krahas problemeve me integritet.
- Sektori bankar është i kapitalizuar mirë dhe mjaft likuid, por karakterizohet me një mospërputhje në rritje midis aseteve dhe borxheve dhe një mungesë të inovacionit duke përfshirë shfrytëzimin e kufizuar të financave për tregti dhe zgjidhjeve për faktorizim.
- Mungesa e përvojës me IFN-të dhe kapaciteti i dobët administrativ për t'i realizuar projektet kryesore të infrastrukturës publike.
- Investimet e huaja kryesisht të kufizuara në investimet në pasuri të paluajtshme (dy të tretat e fluksit) nga diaspora për shkak të perceptimit negativ për mjedisin për biznesit dhe mungesës së mundësive për investime.
- Kosova ka qenë e ngadaltë dhe e pavendosur në diversifikimin e burimeve të energjisë, duke mbetur pothuajse tërësisht e varur nga qymyri tejet ndotës, edhe si rezultat i kapacitetit të ulët institucional dhe sfidave në tërheqjen e investimeve.

Mësimet kryesore dhe ruga përpara

- Kredithënia direkte funksionon kur kombinohet me asistencë teknike (posaçërisht me këshillat për të kultivuar marrëdhënie afatgjata dhe për t'i përgatitur klientët për financim) si dhe duke i mobilizuar fondet e donatorëve për t'i mbuluar shpenzimet e larta ligjore dhe për ta mbështetur krijimin e vlerës pas investimit.
- Fondet e kombinuara për Fi-të (me AT dhe grante për investim) së bashku me këshillat janë mekanizëm i mirë për ta arritur tek zonat e nënshërbyera dhe për të siguruar çmime konkurruese. Mbështetja e programit për lehtësimin e tregtisë dhe mbështetja e plasimit të produkteve të reja financiare.
- Plotësimi i investimeve në infrastrukturën publike me ngritje të shtuar të kapaciteteve institucionale, p.sh. mbështetja për përgatitje dhe zbatim të projekteve në nivelin qendror dhe atë komunal.
- Përqendrimi i shtuar në përmirësimin e klimës për investime, nëpërmjet dialogut më efektiv publiko-privat, si dhe krijimi i më shumë mundësive për t'i tërhequr IHD-të në sektorët prodhues të ekonomisë (p.sh. përmes parqeve të biznesit, zonave ekonomike).
- Investimet në energjinë e ripërtëritshme kërkojnë ndërtimin e kapaciteteve dhe asistencë praktike për të krijuar skema të mbështetjes rregullative. Ndihma për politikëbërësit në hartimin e një Strategji për Energji bindëse së bashku me angazhimin e BERZH-it në planifikimin e Tranzicionit të Drejtë.

2. Konteksti ekonomik

2.1. Konteksti makroekonomik dhe perspektiva për periudhën strategjike



European Bank
for Reconstruction and Development

Kosova - Indikator makroekonomikë kryesorë

	2017	2018	2019	2020
Rritja e BPV-së (% vnv)	4.8	3.4	4.8	-5.3
Inflacioni i IPK-së (% mesatarisht)	1.5	1.1	2.7	0.2
Bilanci i qeverisë (% e BPV-së))	-1.4	-2.8	-2.9	-7.8
Bilanci aktual i llogarisë (% e BPV-së))	-5.7	-7.8	-5.8	-6.7
IHD-të neto (% e BPV-së)) [minusi e tregon fluksin hyrës]	-3.3	-3.4	-2.7	-4.2
Borxhi i jashtëm (% e BPV-së))	32.9	30.5	31.2	37.2
Rezervat bruto (% e BPV-së))	10.8	11.54	12.2	13.3
Borxhi i përgjithshëm qeveritar bruto (% e BPV-së)	16.2	17.0	17.6	24.1
Shkalla e papunësisë (%)	30.3	29.4	26.0	26.2
BPV-ja nominale (mlrd. \$)	7.2	7.9	8.0	7.8

Rritja ekonomike ka qenë e orientuar kryesisht kah konsumi gjatë dekadës së fundit. Midis viteve 2010 dhe 2019, rritja ka qenë mesatarisht 3.6 përqind në vit dhe udhëhequr kryesisht nga kërkesa e brendshme, e në veçanti nga konsumi privat, ndërsa kontributi i investimeve ka qenë dukshëm më i vogël. Në anën tjetër, eksporti neto ka vepruar si forcë tërheqëse për rritje, kryesisht përmes rritjes së importit. Sa i përket prodhimit, rritja është nxitur kryesisht nga shërbimet, kryesisht ato që ndërlidhen me tregtinë dhe turizmin. Pavarësisht nga një rënie që nga viti 2015, shkalla e papunësisë ka mbetur e lartë, posaçërisht për të rinjtë.

Ekonomia po rimëkëmbet fuqimisht pas një recesioni në vitin 2020, ndihmuar nga mjedisi i jashtëm përkrahës. Eksportet ishin midis shtytësve më kryesorë të rritjes në tre çerekët e parë të vitit 2021, për shkak të rritjes së konsiderueshme të vizitave të diasporës, të cilat rritën të ardhurat e shërbimeve, por edhe zgjerimit të fortë të eksporteve të mallrave. Rritja solide në konsumin amvisnor u përforcua nga rrjedhat hyrëse të remitencave që vazhdimisht rriten. Nga perspektiva e sektorit, rimëkëmbja nxitet nga rritja e fortë e tregtisë vendore dhe prodhimit. Pas asaj që ishte gati stagnim më 2020, inflacioni ishte në rritje më 2021, nxitur nga çmimet e rritura të energjisë dhe ushqimit.

Qëndrimi fiskal është liruar. Për ta lehtësuar krizën, qeveria e ka miratuar së pari një pako emergjente, e cila është pasuar nga një pako për rimëkëmbje. Si rezultat, borxhi publik u rrit. Politika fiskale ekspansioniste vazhdoi në vitin 2021.

Në vitin 2021, ekonomia pritet të tejkalojë nivelin e saj të vitit 2019. Rritja ekonomike duhet të nxitet kryesisht nga kthimi i konsumit, investimeve dhe aktiviteteve të udhëtimit dhe turizmit që ndërlidhen me diasporën e madhe të vendit. Rreziqet ndaj projeksioneve janë të baraspeshuara, si dhe kryesisht lidhen me dobësitë potenciale në sektorin e jashtëm, si dhe rrugëtimin të mëtutjeshëm të pandemisë. Rreziqe të tjera gjenden në fushën e menaxhimit të investimeve publike të vendit. Një rimëkëmbje më e shpejtë do të ndihmohej nga përshtetimi i zbatimit deri tani të ngadaltë të projekteve infrastrukturore kryesore.

2. Konteksti ekonomik

2.2. Sfidat kryesore të tranzicionit




European Bank
for Reconstruction and Development

Konkurruese (5.2)

- Ekonomia dominohet nga **mikro-ndërmarrjet familjare**.
- **Ekonomia joformale e përhapur gjerësisht** (vlerësohet se arrin deri në 40 përqind të BPV-së): në AMBPN VI, një e katërta e kompanive e kanë zgjedhur konkurrencën nga sektori joformal si pengesën kryesore për të bërë biznes. Shkalla e lartë e informalitetit krijon konkurrencë të padrejtë midis kompanive, e bën më të vështirë qasjen e tyre në financa dhe i pengon kompanitë që të zhvillohen më shpejt.
- Ende ka **mjedis të pafavorshëm për biznes** për shkak të dobësive rregullative dhe institucionale, përkundër përmirësimeve të dukshme.
- **Cilësia e ulët e arsimit dhe mungesa e shkathtësive** rëndojnë mbi aftësinë konkurruese të ekonomisë.
- Vendi është në një **fazë të hershme të ekonomisë së njohurive**, duke mbetur pas shteteve homologe në rajon.
- **Ndërhyrja e shtetit në formën e subvencioneve** është relativisht e lartë (1.8 përqind e BPV-së në vitin 2017).

Pengesat më të mëdha për të bërë biznes (përqindja e firmave)




Burimi: BEEPS VI

E qeverisur mirë (4.7)

- Rezultatet e vendit janë **nën mesataren rajonale në kuadër të Indikatorëve të Qeverisjes Botërore të Bankës Botërore**, me performancën më të dobët në fushat e stabilitetit politik dhe mungesës së dhunës, si dhe kontrollit të korrupsionit.
- **Sundimi i ligjit mbetet i dobët**, përkundër përpjekjeve të konsiderueshme ndërkombëtare gjatë dy dekadave të fundit. Sistemi gjyqësor është mjaft i ngadaltë dhe joefikas, i prirë kah ndërhyrjet politike.
- Edhe administrata publike jo mjaft transparente, efikase dhe e përgjegjshme i kontribuon një **mbizotërimi më të madh të korrupsionit**. Kosova renditet e 140-ta në mesin e 180 vendeve në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2020.
- **Zbatimi i kontratave është bërë më i lehtë** kohëve të fundit, por kostoja është ende relativisht e lartë.
- Informaliteti i madh u kontribuon **të ardhurave qeveritare ndër më të ulëta në Evropë**.
- **Korniza i qeverisjes së korporatave është e një force mesatare**, por qeverisja korporative e NSH-ve është e dobët.

Indikatorët e qeverisjes




Burimi: Indikatorët e Bankës Botërore për Qeverisjen në mbarë Botën 2018

E gjelbër (3.3)

- Sistemi i energjisë mbështetet në linjit, lëndë djegëse kjo me energji të ulët dhe shumë ndotëse. Pothuajse e tërë energjia elektrike prodhohet nga **dy termocentrale të vjetruara dhe joefikase me qymyr** (Kosova A dhe Kosova B).
- **Ndotja e pakontrolluar e ajrit** nga sektori i energjisë dhe ngrohja e shtëpive mbetet një çështje serioze, me një ndikim të rëndë shëndetësor.
- **Intensiteti i energjisë është ndër më të lartit në rajon** dhe pothuajse katër herë më i lartë se mesatarja e BE-së.
- Burimi kryesor i ripërtëritshëm i energjisë elektrike janë **hidrocentralet**, shumë nga të cilët janë të vegjël dhe shpesh shkaktojnë dëme në mjedis.
- Burimet ujore janë të shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në tërë vendin. **Ndryshimet klimatike mund ta përkeqësojnë disponueshmërinë dhe cilësinë e ujit**, veçanërisht gjatë muajve të verës.
- **Sistemi i menaxhimit të mbeturinave është i pazhvilluar dhe joefikas**, me shumë deponi ilegale dhe riciklim të kufizuar; mungesa e qendrave të trajtimit të ujërave të zeza.

VP.5 Vdekjet e parakohshme (për 1.000 të popullsisë)



Burimi: Llogaritjet e AEE-së dhe autorëve

2. Konteksti ekonomik

2.2. Sfidat kryesore të tranzicionit




European Bank
for Reconstruction and Development

Përfshirëse (5.4)

- **Pjesëmarrja në tregun e punës është e ulët**, veçanërisht për gratë: afro 80 përqind e grave janë ekonomikisht joaktive.
- **Shkalla e punësimit është dukshëm më e ulët për gratë** sesa për burrat (14 përqind kundrejt 43 përqind në vitin 2020), ndërsa ka **hendon të madh gjinor sa i përket qasjes në financa**.
- Informaliteti në Kosovë është ndër më të lartët në Evropë, me **më shumë se një e treta e punonjësve** treta e popullsisë kosovare ka migruar. Remitancat e mëdha të pastajme i zvogëlojnë më tej stimujt për të punuar.
- **Shkalla e lartë dhe e vazhdueshme e papunësisë**, veçanërisht për të rinjtë, dhe brishtësia sociale i kanë kontribuar **migrimit të madh**. Të paktën një e ekonomiksht joaktive.
- Kosova e ka **popullsinë më të re në Evropë**, me një moshë mesatare prej 29.5 vjeç.
- Sistemi arsimor nuk u përgjigjet sa duhet nevojave të sektorit privat, prandaj edhe ka **mospërputhje të shkathtësive**.

Shkalla e papunësisë
(përqind)




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

E qëndrueshme (5.5)

- **Sistemi financiar** dominohet nga bankat, shumica e të cilave (tetë nga dhjetë) janë në pronësi të huaj. Institucionet mikrofinanciare janë gjithashtu të pranishme.
- Sektori bankar është i kapitalizuar mirë dhe likuid, me **përqindjen më të ulët të aseteve me cilësi të ulët në rajon**. Përqindja e KJP-ve ka qenë 2.2 përqind në TM3 të vitit 2021.
- Ka **vend për më shumë thellim financiar**. Në fund të vitit 2020, kredia e sektorit privat ishte nën 48 përqind të BPV-së.
- **Tregjet e kapitalit mbeten të pazhvilluara**. Vendi nuk ka bursë, ndërsa instrumentet financiare përbëhen nga bono thesari dhe obligacionet qeveritare.
- **Sektori i energjisë elektrike** ka kaluar nëpër një proces të ndarjes, por pjesëmarrja e sektorit privat mbetet e kufizuar. Çmimet e energjisë elektrike për përdoruesit fundorë janë ende të rregulluara dhe mbeten disa subvencione të kryqëzuara.
- **Nuk ka treg të krijuar të gazit**.

Kreditë joperfomuese
(%)




Burimi: FMN-ja dhe autoritetet kombëtare

E integruar (5.1)

- Në nën 80 përqind të BPV-së në vitin 2020, **hapja e tregtisë është e dyta më e ulët në rajon**.
- **Eksporti pothuajse i shpërfillshëm i mallrave** (rreth pesë përqind e BPV-së) përmbajnë kryesisht metale bazë, produkte minerale dhe ushqime.
- Ndonëse përbëjnë një të katërtën e BPV-së, **eksportet e shërbimeve konsistojnë kryesisht në shërbimet e udhëtimit**, të cilat ndërlidhen me diasporën e madhe të vendit.
- Kosova ende **mbetet mjaft pas BE-së në infrastrukturën e transportit** si dhe në kapacitetin e instaluar për prodhimin e energjisë dhe rrjetet telekomunikuese, i cili potencialisht e shpërqendron vëmendjen e investitorëve të huaj dhe e kufizon integrimin e vendit në zinxhirët e furnizimit evropian.
- **Stoku i IHD-ve për kokë banori është më i ulët në rajon**, edhe pse Kosova është vendi më së paku kufizues.
- **Ndërprerjet e energjisë janë relativisht të shpeshta**, duke shkaktuar humbje të mëdha tek kompanitë (pothuajse katër përqind e shitjeve vjetore, sipas BEEPS VI).

Hapja e tregtisë
(përqindja e BPV-së)



Burimi: IZhB-të e BB-së

3. Prioritetet qeveritare dhe angazhimi i akterëve



European Bank
for Reconstruction and Development

3.1. Prioritetet e reformës qeveritare

Sipas Programit të Qeverisë 2021-2025, dy përparësitë më urgjente janë që së pari të menaxhohet pandemia, duke e synuar minimizimin e pasojave të shëndetit publik, dhe që së dyti zbutet ndikimi ekonomik dhe social i saj. Prioritetet e rimëkëmbjes ekonomike përfshijnë: ngritjen e pagës minimale, riorientimin e ekonomisë kah prodhimi dhe eksporti, punësimin e të rinjve, angazhimin e diasporës, fuqizimin ekonomik të grave, përmirësimin e menaxhimit të pasurive strategjike shtetërore, mbështetjen e shtuar për zhvillimin e sektorit privat si dhe përgatitjen e një Strategjie Kombëtare për Zhvillim.

Programi për Reforma në Ekonomi 2021-2023 i publikuar në janar të vitit 2021 (në përputhje me SKZh-në aktuale, programin e MSA-së dhe dokumentet strategjike të tjera) përqendrohet në:

Energji: zvogëlimi i konsumit të energjisë përmes masave të eficiencës së energjisë, duke i diversifikuar burimet e energjisë.

Bujqësi, industri dhe shërbime: zhvillimi i reformave në bujqësi, përmirësimi i prodhimit, aftësia konkurruese në turizëm dhe mikpritje dhe tregtia me shërbime.

Mjedis të biznesit dhe informalitet: miratimi i politikave të bazuara në prova, zvogëlimi i barrës administrative, kryerja e Reformës së Inspektimit të Përgjithshëm, krijimi i një Gjykate Komerciale, zvogëlimi i informalitetit në sektorin e pasurive të patundshme, por edhe në tërë ekonominë, përmes përmirësimit të sundimit të ligjit dhe qeverisjes ekonomike.

Kërkim, zhvillim, inovacion dhe ekonomi digjitale: përmirësimi i mjedisit për inovacion dhe sipërmarrje, zgjerimi i rrjeteve të TIK-ut dhe infrastrukturës së shërbimeve për ta nxitur zhvillimin socio-ekonomik.

Reforma tregtare: lehtësimi i tregtisë përmes uljes së kostove të transaksioneve ndërkufitare, zhvillimi i infrastrukturës cilësore dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

Arsim dhe shkathtësi: zhvillimi i arsimit në fëmijëri të hershme, zbatimi i kornizës së re të kurrikulës për AFP, rritja e cilësisë së arsimit të lartë.

Punësim dhe treg të punës: përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike të punësimit, rritjen e numrit të punësuarëve të grupeve të cënueshme, në veçanti të të rinjve, grave, njerëzve në varfëri dhe zonave rurale.

Mbrojtje dhe përfshirje sociale: përmirësimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore dhe fuqizimin e grupeve të përjashtuara.

3.2. Zonat e Reformës së BERZH-it të dakorduara përgjithësisht me autoritetet

- Të ringjallet ekonomia e Kosovës nga ndikimi i krizës pandemike COVID-19.
- Të forcohet produktiviteti i prodhuesve kosovarë, veçanërisht kapaciteti i tyre për eksport, dhe të ndihmohet zhvillimi i zinxhirëve të vlerës për ta diversifikuar ekonominë.
- Të përmirësohet tregtia përmes përmirësimit të zbatimit të standardeve, logjistikës më të mirë dhe financimit të tregtisë.
- Të përmirësohet performanca dhe qeverisja e ndërmarrjeve publike. Të vazhdohet të mbështet kalimi në ekonominë e gjelbër dhe të zvogëlohet konsumi i energjisë në Kosovë për t'u bërë më rezistente ndaj klimës dhe për ta shfrytëzuar nismën e tranzicionit të BERZH JUST.
- Të mbështetet hartimi i një politike kombëtare për investimet e huaja për ta rritur fluksin e IHD-ve dhe financimin e infrastrukturës së nevojshme.

3.3. Mesazhet kryesore nga Shoqëria Civile për BERZH-in

1. Organizatat e shoqërisë civile e kanë miratuar prioritetin e strategjisë së Bankës për Kosovën për ta krijuar një sektor privat më konkurrues dhe më gjithëpërfshirës. Në veçanti, OSHC-të konsiderojnë se mbështetja e BERZH-it është e nevojshme në fushën e lehtësimit të qasjes në tregun e punës dhe financim, duke përfshirë për pakicat, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara në mënyrë të dyfishtë, siç janë gratë brenda pakicave. Gjithashtu, migrimi dhe ikja e trurit janë fusha shqetësuese për OSHC-të.
2. OSHC-të për më tepër e kanë mirëpritur mbështetjen e Bankës për Tranzicionin e Ekonomisë së Gjelbër përmes një kombinimi më të qëndrueshëm të energjisë dhe eficiencës më të madhe të burimeve. Ato kanë theksuar se menaxhimi i mbeturinave, riciklimi dhe ekonomia qarkore janë fusha kyçe për OSHC-të, të cilat duan të shohin më shumë veprime në këtë fushë. Përveç kësaj, OSHC-të konsiderojnë se tranzicioni drejt gazifikimit dhe energjisë së ripërtëritshme duhet të jetë shumë i kujdesshëm dhe i bazuar në dëshmi.
3. Përfaqësuesit e shoqërisë civile e kanë mbështetur pastaj përqendrimin e Bankës në forcimin e integritetit rajonal, konektivitetit dhe investimeve të huaja. Sipas OSHC-ve, BERZH duhet të ndihmojë në promovimin e më shumë investimeve dhe përpjekjeve të bashkërenduara për t'i tërhequr IHD-të.

4. Caktimi i prioriteteve të strategjisë së vendit për Kosovën



European Bank
for Reconstruction and Development

Çfarë duhet të ndryshojë?

(Diagnostika e Vendi)

A mund të ndryshohet?

(Ekonomia politike)

Çfarë mund të bëjë Banka?

(Aftësitë institucionale)

- Cenueshmëri në rritje në sektorin financiar si rezultat i mospërputhjes midis aseteve dhe borxheve, me probabilitet të KJP-ve më të larta pas Covid.
- Produktiviteti i ulët dhe qasja e kufizuar në financa.
- Niveli i lartë i informalitetit dhe pabarazitë rajonale.
- Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqi punëtore dhe mbështetja e kufizuar e biznesit për gratë dhe të rinjtë.
- Shkalla e lartë e papunësisë, AAPT i kufizuar dhe mungesa e aftësive.
- Klima sfiduese e biznesit.
- Performanca e dobët e ndërmarrjeve shtetërore.

- Përpjekjet e qeverisë dhe strategjia e rishikuar për ta ngritur vetëdijen dhe për ta kufizuar informalitetin në të tërë ekonominë.
- Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është prioritet i qeverisë.
- Potencial i lartë sipërmarrës në mesin e të rinjve të Kosovës.
- Angazhimi për të forcuar dialogun publiko-privat dhe për ta përmirësuar mjedisin për biznes.
- Qeveria e sinjalizon interesimin e saj për komercializimin e NSH-ve dhe përmirësimin e standardeve.

- Ekspertiza në forcimin e qëndrueshmërisë financiare përmes financimit afatgjatë dhe zgjidhjeve për KJP-të.
- Gama e instrumenteve të synuara për ta rritur aftësinë, shkathtësitë dhe përfshirjen financiare të NVM-ve (GnB, këshilla për biznes).
- Platformat e provuara dhe testuara për ta lehtësuar dialogun publiko-privat për mjedisin për biznesit dhe klimën për investime.
- Ekspertiza në mbështetjen e komercializimit të NSH-ve.
- Përvoja në sigurimin e financave dhe këshillave të kompanive për ta përmirësuar qeverisjen, standardet dhe kapacitetin e korporatave.

- Shkalla e lartë e ndotjes së ajrit për shkak të ngrohjes së banesave dhe emetimit të gazrave nga automjetet, mbështetja në qymyr dhe burimet e ripërtëritshme të kufizuara në kombinimin e energjisë.
- Dominimi i shtetit në shërbimet kryesore.
- Shkalla e ulët e investimeve në energji të ripërtëritshme, mungesa e rregulloreve dhe PSP e kufizuar.
- Shkalla e elartë e përdorimit të energjisë dhe intensiteti i karbonit në ndërtesat e banimit dhe ato komerciale (katër herë më i lartë se mesatarja e BE-së).
- Infrastruktura e dobët komunale e përqësuar nga efikasiteti i ulët i burimeve dhe mungesat e ujit.
- Çmimet e energjisë elektrike për përdoruesit fundorë janë ende të rregulluara dhe mbeten disa subvencione të kryqëzuara.

- Qeveria planifikon t'i tërheqë gradualisht subvencionet për energjinë elektrike (Strategjia e Energjisë 2017-2026).
- Vullneti i qeverisë për ta rishikuar strategjinë e energjisë dhe për ta përshtatur atë me praktikën më të mira të BE-së (Agjenda e Gjellbër në Samitin e Sofjes 2020).
- Marrëveshjet e normalizimit ekonomik midis Kosovës dhe Serbisë mund ta hapin rrugën për t'i zgjidhur çështjet e furnizimit me ujë dhe energji.
- Përpjekjet e qeverisë për t'i ndërtuar kapacitetet e reja dhe të avancuara të gjenerimit të energjisë.
- Ligji për Investimet Strategjike që është miratuar në vitin 2017 e ka identifikuar sektorin e energjisë si sektor strategjik për t'i rritur investimet.

- Zbatimi i strategjisë GET 2.1.
- Përvoja në ndarjen dhe mbështetjen e praktikave më të mira në kornizën rregullative dhe institucionale për energjinë e ripërtëritshme në të gjitha ekonomitë e BERZH-it.
- Ekspertiza e BERZH-it në udhëheqjen e investimeve në teknologjitë e reja të gjelbra.
- Produkte specifike financiare të përshtatura për t'i financuar investimet e gjelbra (p.sh. Kornija e Qyteteve të Gjelbra, linjat e kreditit të GEFF).
- Përvoja në zhvillimin e IKM-ve të qëndrueshme financiarisht dhe në aspektin mjedisor, duke përfshirë shërbimet e mbeturinave dhe ujërave të zeza.

- Cilësia dhe konektiviteti i dobët e infrastrukturës së transportit, posaçërisht rrugëve dhe hekurudhave.
- Kapaciteti i dobët për zbatimin e projekteve të projekteve infrastrukturë të mëdha.
- Eksporti i kufizuar dhe integrimi i dobët në ZVG-të për NVM-të.
- Nivelet e ulëta të IHD-ve (më të ulëta në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor), dhe përqendrimi i madh në sektorin joproduhës (2/3 e pasurive të paluajshme).

- Korridoret mbarevropiane dhe agjenda e konektivitetit të transportit rajonal, RJTE-T si spiranca kryesore.
- Interesimi i fortë i qeverisë siç është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Transportit dhe Planin e Veprimit (2015-2025) dhe angazhimi për ta përshpejtuar zbatimin e projektit infrastrukturor.
- Mundësitë për avancimin e konektivitetit të butë në funksion të përafërimit dhe përshtatjes me marrëveshjet e BE-së për tregtinë dhe investimet rajonale (përfshirë tregun rajonal të përbashkët).
- Ka potencial për eksport dhe zhvendosje afër vendit (BE-ja është partneri më i madh tregtar), por përdorimi i këtij potenciali varet nga zhvillimi i tregut rajonal të përbashkët.

- E kaluara e fuqishme e BERZH-it në sigurimin e fondeve për të ndihmuar në ngushtimin e hendekut të infrastrukturës dhe mbështetjen e zbatimit të projekteve infrastrukturë komplekse.
- Shtesa dhe përvoja e fuqishme e BERZH-it në drejtimin e agjendës rajonale për konektivitet të butë.
- Ekspertiza e BERZH-it në lehtësimin e tregtisë dhe mbështetjen e kompanive të orientuara kah eksporti.

Prioritetet strategjike (2022-2027)

Çfarë duam të shohim në vitin 2027

Ta krijojnë një sektor privat më konkurrues dhe më përfshirës për ta nxitur rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike

- Forcimi i qëndrueshmërisë dhe aftësisë konkurruese të sektorit privat pas COVID-it
- Qasja e avancuar gjithëpërfshirëse në financa, shkathtësi dhe sipërmarrje
- Përmirësim i qeverisjes së NP-ve dhe sektorit privat

Ta mbështesë tranzicionin në ekonomi të gjelbër në Kosovë përmes një kombinimi më të qëndrueshëm të energjisë dhe eficiencës më të madhe të resurseve

- Rritja e kapacitetit të energjisë së ripërtëritshme dhe një kombinim më i diversifikuar i energjisë
- Eficienca e shtuar e energjisë dhe burimeve
- Infrastruktura dhe shërbimet komunale dhe të transportit urban më të qëndrueshme dhe më rezistente ndaj klimës

Ta forcojë integrimin rajonal, konektivitetin dhe investimet e huaja.

- Lidhja e përmirësuar dhe integrimi i infrastrukturës kritike
- Tregtia dhe investimet ndërkufitare të avancuara

5. Aktivitetet dhe korniza e rezultateve



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 1: Ta krijojë një sektor privat më konkurrues dhe më përfshirës për ta nxitur rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike;

Objektivat (rezultatet) kryesore	Aktivitetet (produktet)	Indikatorët përcjellës (Rezultatet)
Forcimi i qëndrueshmërisë dhe aftësisë konkurruese të sektorit privat pas COVID-it	- Forcimi i qëndrueshmërisë së sektorit financiar përmes një kombinimi të financimit (përfshirë ofrimin e financimit afatmesëm dhe afatgjatë) dhe mbështetjes së politikave rregullative, p.sh. qeverisja korporative e bankave, zgjidhja e bankave, sigurimi i depozitave, komercializimi i IMF-ve. - Ofrimi i financimit dhe këshilla të drejtpërdrejta për korporatat dhe ndërmarrjet e mesme për ta mundësuar rritjen e tyre, për ta përmirësuar qeverisjen e korporatave dhe krijimin e vlerave. - Mbështetja e NVM-ve lokale për t'i përtëritur, digjitalizuar dhe miratuar standardet e BE-së dhe për ta rritur produktivitetin përmes financimit dhe këshillave indirekte për biznes (p.sh. aftësia dhe rimëkëmbja e NVM-ve, Këshillat për Bizneset e Vogla). - Shqyrtimi i zgjerimit të gamës së produkteve, duke përfshirë financimi i ndërmjetëm, garancitë, lehtësitë e ndarjes së rrezikut.	- Nr. i klientëve që që e shtojnë produktivitetin - Nr. i përmirësimeve ligjore/institucionale/rregullative në segmentin e synuar
Qasja e avancuar gjithëpërfshirëse në financa, shkathtësi dhe sipërmarrje	- Mbështetja për gratë dhe të rinjtë në biznes, si dhe për pakicat rajonale dhe etnike duke zgjeruar dhe zhvilluar programe të reja të financimit dhe këshillëdhënies, siç janë garancitë për të rinj, që shenjestrojnë segmentet e tregut të cilave nuk u ofrohen shërbime të mjaftueshme. - Mbështetja e zgjerimeve të teknologjisë përmes këshillimit dhe financimit, ndërtimit të kapaciteteve për përsheptuesit e biznesit dhe zhvillimit të teknologjisë financiare. - Shqyrtimi i mundësive për ta mbështetur sektorin privat për të zhvilluar trajnime gjatë punës dhe programe të aftësimit profesional dhe përfshirjes, me një fokus tek të rinjtë dhe gratë. - Vazhdoni të zgjeroni gamën e produkteve në dispozicion për financimit, siç janë faktorizimi dhe qiradhënia, të kombinuar me ndërtimin e kapaciteteve për institucionet rregullative dhe financiare.	- Nr. i kredive të disbursuara nga institucionet financiare partnere për N(M)VM-të e udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë - Nr. i individëve që avancojnë aftësitë e tyre si rezultat i trajnimit
Qeverisje e përmirësuar e NP-ve dhe sektorit privat	- Angazhimi i politikave për ta përsheptuar reformimin e NP-ve duke e harmonizuar kornizën ligjore me praktikatat më të mira, duke e azhurnuar politikën shtetërore për pronësinë dhe duke e përmirësuar kapacitetin për monitorim dhe mbikëqyrje. - Mbështetja për komercializimin e NSH-ve/NP-ve aktuale dhe të mëparshme (financiare, operationale, për qeverisje të korporatave) përmes këshillimit të politikave dhe këshillimit për politika dhe investime. - Lehtësimi i dialogut midis sektorit publik dhe atij privat përmes instrumenteve si Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime për t'i identifikuar dhe adresuar pengesat ligjore dhe rregullative për zhvillimin e sektorit privat. - Trajtimi i kufizimeve të përzgjedhura kritike në mjedisin për biznes, siç është mbështetja e zbatimit të kontratave përmes gjykatave komerciale, shërbimeve të përmbarimit dhe përforsimi i kornizës ligjore dhe rregullative për falimentim, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për mbajtësit e posteve (administratorët dhe gjyqtarët).	- Politika për pronësinë shtetërore e miratuar nga qeveria - Nr. i klientëve që e zbatojnë komercializimin/ristrukturin

5. Aktivitetet dhe korniza e rezultateve



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 2: Ta mbështesë tranzicionin në ekonomi të gjelbër në Kosovë përmes një kombinimi më të qëndrueshëm të energjisë dhe eficiencës më të madhe të resurseve;

Objektivat (rezultatet) kryesore	Aktivitetet (produktet)	Indikatorët përcjellës (Rezultatet)
Rritja e kapacitetit të energjisë së ripërtëritshme dhe një kombinim më i diversifikuar i energjisë	- Kombinimi i angazhimit të politikave (p.sh. korniza e avancuar ligjore dhe rregullative) me financim direkt dhe indirekt për zhvillimin dhe integrimin e mëtejshëm të projekteve të reja të energjisë së ripërtëritshme të prokuruar në mënyrë konkurruese. - Promovimi i kalimit në burimet më të pastra të energjisë për ta garantuar sigurinë e energjisë dhe trajtuar ndotjen akute të ajrit dhe intensitetin e karbonit, përfshirë mbështetjen për rishikimin e strategjisë ekzistuese të energjisë së Kosovës dhe investimet potenciale në kalimin nga qymyri në gaz, por vetëm aty ku është në përputhje me përpjekjet e dekarbonizimit të Kosovës. - Pjesëmarrja në Nismën e Platformës së Tranzicionit të Drejtë në mbështetje të rajoneve të qymyrit në tranzicion në Ballkanin Perëndimor. - Angazhimi i politikave për të promovuar dhe krijuar stimuj për investime në rrjetin inteligjent dhe investime në infrastrukturën e rrjetit elektrik për të thithur energji të ripërtëritshme të përhershme.	- Gjithsej energjia e ripërtëritshme e instaluar - Korniza ligjore dhe rregullative për ankandet konkurruese të furnizimit me energji të ripërtëritshme
Eficiency e shtuar e energjisë dhe burimeve	- Ofrimi i financimit direkt dhe indirekt dhe këshillat për eficiencën e energjisë dhe burimeve të NVM-ve dhe korporatave (Programi i Aftësisë Konkurruese të NVM-ve, programi Reboot, financat e tregtisë së gjelbër). - Ofrimi i financimit indirekt për ta përmirësuar eficiencën e energjisë dhe burimeve të ndërtesave të banimit dhe publike, përfshirë përmes GEFf dhe produkteve të tjera të gjelbra. - Angazhimi i politikave për t'i eliminuar barrierat ndaj investimit në eficiencë të energjisë dhe burimeve. - Mbështetja e zhvillimit të një ekonomie qarkore përmes investimeve dhe këshillave për zgjidhje për eficiencë të burimeve.	- Energjia e kursyer (GJ/v) - Gjithsej CO₂ i reduktuar/evituar (ton/vit)
Infrastruktura dhe shërbimet komunale më të qëndrueshme dhe më rezistente ndaj klimës	- Mundësojuani qyteteve që të merren me çështjet e cilësisë së ajrit përmes financave dhe AT , p.sh., ngrohja qendrore solare, projektet e transportit urban, kur janë relevante në kuadër të Kornizave të Qyteteve të Gjelbra dhe programeve të tjera të synuara të BERZH-it (p.sh. ReDeWB). - Mbështetja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së shtuar në sektorin e ujit, përfshirë trajtimin e ujërave të zeza dhe sigurinë e ujit (p.sh. kanali Ibër-Lepenc), dhe shqyrtimi i mundësive për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. - Mbështetja e qyteteve për të hartuar plane të veprimit për rezistencë ndaj klimës dhe të gjelbra dhe për ta vazhduar ndërtimin e kapaciteteve për ta forcuar zbatimin e projekteve komunale dhe shërbimeve digjitale. - Promovimi i deklarimeve lidhur me klimën nga NP-të përmes planeve të veprimit për qeverisje klimatike korporative.	- Nr. i planeve të veprimit për rezistencë klimatike dhe të gjelbra të miratuara - Kursimet e ujit (m³/vit)

5. Aktivitetet dhe korniza e rezultateve



European Bank
for Reconstruction and Development

Prioriteti 3: Ta forcohen integrimi rajonal, konektiviteti dhe investimet e huaja.

Objektivat (rezultatet) kryesore	Aktivitetet (produktet)	Indikatorët përcjellës (Rezultatet)
Lidhja e përmirësuar dhe integrimi i infrastrukturës kritike	- Forcimi i kapacitetit për ta mbështetur përgatitjen dhe zbatimin e projekteve dhe shqyrtimi i mundësive për avancimin e kornizave për PPP. - Vazhdimi i mbështetjes për reforma në sektorin e hekurudhave, duke përfshirë qasjen në menaxhimin dhe përcjelljen e aseteve të infrastrukturës hekurudhore. - Financimi dhe ofrimi i këshillave për korridoret rrugore kryesore dhe rehabilitimi i rrjetit rrugor rajonal dhe lokal (p.sh. 'Autostrada e Paqes' dhe rruga unazore e Prishtinës) me fokus të shtuar në rezistencën ndaj klimës. - Hulumtimi dhe mbështetja e investimeve në transmissiionin ndërkufitar (të energjisë elektrike dhe potencialisht gazit) me vendet fqinje, me fokus në interkoneksionet me Maqedoninë e Veriut dhe/ose Shqipërinë. - Identifikimi i mundësive për përf forcimin e telekomunikacionit dhe infrastrukturës digjitale, duke përfshirë edhe përmes financimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit përmes telefonisë fikse dhe mobile dhe azhurnimin e tyre (p.sh. broadband, 5G) së bashku me angazhimin e politikave për çështje ligjore dhe rregullative (p.sh. skema e licencimit përmes konkurrencës).	Rrjeti i synuar i infrastrukturës i zgjeruar i matur sipas rritjes së kapacitetit të rrjetit
Tregtia dhe investimet ndërkufitare të avancuara	- Mbështetja e zhvillimit të platformave rajonale të biznesit (regjistrat rajonalë të bizneseve) dhe harmonizimi i praktikave afariste (shkëmbimi i të dhënave afariste dhe financiare) dhe shqyrtimi i mëtejme i mundësive për ta mbështetur tregun e përbashkët rajonal. - Ofrimi i këshillave dhe financave për bizneset e orientuara kah eksporti që shërbejnë në tregjet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe inkurajimi i mundësive për kontraktim të afërt (near-shoring). - Zgjerimi i Programit të Lehtësimit të Tregtisë, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për ndërmjetësuesit, ngritjen e vërtëdijes midis importuesve dhe eksportuesve vendas dhe financimin e tregtisë digjitale. - Financimi i IHD-të brenda vendit, me fokus në integrimin e zinxhirëve të vlerave dhe bartjen e teknologjisë tek furnitorët lokalë, së bashku me krijimin e mundësive për IHD-të përmes zonave ekonomike dhe parqeve të biznesit. Inkurajimi i angazhimit dhe investimit më të madh të diasporës, në veçanti për gratë.	- Nr. i kredive të disbursuara për PLT sipas institucionit financiar partner - Numri i klientëve/furnitorëve të asistuar që i azhurnojnë proceset, teknologjinë, standardet ose praktikatat si mënyrë për ta rritur eksportin

6. Harta e Përplotësimit të Ndërsjellë të Partnerëve Ndërkombëtarë në Zonat e Biznesit të BERZH-it



European Bank
for Reconstruction and Development

Zonat e biznesit të BERZH-it

		Sektorët:									Temat e gërshetuara			
		Industria, tregtia dhe agrobiznesi					Infrastruktura e qëndrueshme		Institucionet financiare		Nismat strategjike			
Investimet mesatare indikative/ grantet (m€, 2016-2020)		Agrobiznesi	TIK	Prodhimi dhe shërbimet	Burime natyrore	Prona dhe turizmi	Energjia	Infrastrukturë	Bankat	Institucionet financiare jobankare	Ekonomia e gjelbër	Përfshirja dhe gjinia	Valuta vendore dhe tregjet e kapitalit	Biznes i vogël
BB	39	€P	€P				€P	€P	€P		€P	€P		€P
BEI	27		€P					€P			€P			€P
USAID, MCC & DFC	26	€P					€P	€P	€P		€P	€P		€P
KNF	6	€		€					€P					€
BE	17	€P		€P			€P				€P	€P		€P
GIZ & KfW	0.1	€P			€P		€P				€P		€P	
BERZh	75	€P	€P	€P	€P		€P	€P	€P	€P	€P	€P	€P	€P

€ Fusha e dialogut të konsiderueshme

P Fusha e dialogut të konsiderueshëm për politikën

● Përqendrimi kryesisht në sektorin privat

○ Përqendrimi kryesisht në sektorin publik

Fushat për bashkëpunim në të ardhmen

E gjelbër

- Puna me Bankën Botërore, BEI-në, KfW-në dhe SHBA-të për t'i mundësuar investimet në burimet e ripërtëritshme dhe për ta rritur kapacitetin e bankave partnere për t'i financuar investimet e gjelbra.

E qëndrueshme

- Bashkëpunimi me IFN-në për ta mbështetur sektorin financiar për ta nxitur rezistencën ndaj COVID19 dhe rimëkëmbjen nga ai.

E integruar

- Vazhdimi i punës me BEI-në dhe shqyrtimi i mundësive me INF-të e tjera për ta avancuar më tej agjendën e konektivitetit.

E qeverisur mirë

- Puna me INF-të në qeverisjen e sektorit financiar, NP-të, ofrimin e infrastrukturës dhe klimën e investimeve.

7. Rreziqet e zbatimit dhe implikimet mjedisore dhe sociale



European Bank
for Reconstruction and Development

Rreziqet ndaj zbatimit të strategjisë	Probabiliteti	Efekti	Rreziqet ndaj zbatimit të strategjisë
Paqëndrueshmëria politike dhe mungesa e konsensusit lidhur me statusin e Kosovës në bashkësinë më të gjerë ndërkombëtare mund ta pengojë besimin e investitorëve. Kapacitet administrativ i dobët mund ta vonojë zbatimin e reformave si dhe projektet e mëdha kritike infrastrukturore. - Shkalla e pamjaftueshme e bashkëfinancimit nga donatorët dhe e granteve mund ta minojnë aftësinë konkurruese të produkteve kryesore të BERZH-it. Kriza e zgjatur e COVID-19 do ta vonojë rimëkëmbjen ekonomike, do ta kërcënojë qëndrueshmërinë e bizneseve dhe do t'i pengojë investimet afatgjata nga sektori privat dhe publik Mospërputhja e pasurisë/borxheve në sektorin bankar mund ta cenojë qëndrueshmërinë e sektorit financiar.	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimeve M&Sh, angazhimi i akterëve: Sigurimi që ndikimet e drejtpërdrejta, indirekte, kumulative dhe ndërkufitare M&Sh të projekteve të vlerësohen dhe zbuten në mënyrën e duhur dhe që të arrihet një angazhim domethënës i akterëve. Vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve M&Sh përmes BT-ve të synuara për ta siguruar miratimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Puna dhe kushtet e punës: Të siguruarit që politikat e burimeve njerëzore dhe praktikave të punës së klientëve të jenë në përputhje me kërkesat e BERZH-it, i trajtojnë kërkesat për pagat minimale dhe kushtet e punës dhe diskriminimin e mundshëm dhe i promovojnë mundësitë e barabarta. Efikasiteti i resurseve dhe parandalimi dhe kontrolli i ndotjes: Zhvillimi i nismave për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e sektorit të mbeturinave dhe atij të ujit; identifikimi dhe hartimi i projekteve për efikasitet të burimeve ujore dhe nismat e AT-së si pjesë e mandatit të TEGJ; mbështetja e nismave për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me Strategjinë e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave. Shqyrtimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe dialogut për politikat për teknikat më të mira në dispozicion për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes industriale sipas Direktivës së BE-së për Emetimet Industriale. Shëndeti dhe siguria: Përmirësimi i Sh&S profesionale dhe të komunitetit me fokus të veçantë në aktivitetet që konsiderohen burim i aksidenteve të zakonshme në projektet e BERZH-it. Mbështetja e BT është e nevojshme për ta theksuar vazhdimisht rëndësinë e sigurisë rrugore në nivel institucionale dhe të komunitetit. Blerja e tokës, zhvendosja e pavullnetshme dhe zhvendosja ekonomike: Të siguruarit që çdo projekt për të cilin kërkohet blerja e tokës të jetë në përputhje me kompensimin e BERZH-it dhe kërkesat e restaurimit të jetesës, me vëmendje të veçantë në përdoruesit joformalë të tokës dhe grupet në nevojë. Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve institucionale përkritazi me miratimin e praktikave ndërkombëtare. Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla: Të siguruarit e vlerësimeve të biodiversitetit të shëndoshë të projekteve për t'i minimizuar ndikimet e mundshme, posaçërisht në zonat e pasura me biodiversitet për të cilat mund të kërkohet mbështetje shtesë për BT Trashëgimia kulturore: Puna me klientët për t'i identifikuar çështjet e mundshme që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në projektet e Bankës si dhe evitimi dhe zbutja e ndikimeve në trashëgiminë e ndjeshme duke u konsultuar me akterët kryesorë sipas politikës së Bankës. Ndërmjetësuesit financiarë: Të siguruarit që IF-të partnere ta kenë kapacitetin adekuat për çështjet M&S dhe procedura për menaxhim të rrezikut. Monitorimi dhe mbikëqyrja: Puna me klientët për ta monitoruar performancën në çështjet M&S dhe trajtuar çështjet e trashëgimisë që ndërlidhen me portofolin e Bankës. Mbështetja për BT është e nevojshme për ta vazhduar ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e kontraktuesve dhe monitorimin e projekteve midis klientëve të infrastrukturës.

PUBLIC

E lartë

E mesme

E ulët

8. Vlerësimi i bashkëfinancimit nga donatorët



European Bank
for Reconstruction and Development

8.1. Vlerësimi i nevojave për granteve për periudhën e strategjisë së re të vendit


Financim nga donatorë nevojitet për t'i realizuar objektivat strategjikë të strategjisë së vendit, përfshirë për:

- Këshilla dhe ndërtim të kapaciteteve për NVM-të, përfshirë mundësimin e qasjes më gjithëpërfshirëse në mundësitë ekonomike dhe promovimin e sipërmarrjes.
- Aktivitetet e politikës së pronësisë së shtetit dhe angazhimet e qeverisjes së korporatave me ndërmarrjet publike të përzgjedhura.
- Grantet për promovimin e investimeve në eficiencën e energjisë dhe burimeve.
- Asistenca teknike për t'i mundësuar dhe integruar projektet e energjisë së ripërtëritshme.
- Grantet për bashkinvestime dhe AT për t'i mundësuar investimet në shkallë të gjerë në infrastrukturë, për ta përmirësuar kapacitetin për zbatim të projekteve dhe për t'i mbështetur investimet në infrastrukturën e qëndrueshme komunale.
- Dialogu për politika dhe reforma për ta përmirësuar klimën e investimeve, përfshirë përmes mbështetjes për Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Indikatorët e përzgjedhur të përballueshmërisë

	Rangu rajonal i BERZH-it në përqindje ¹	
BPV për kokë banori (BPV, aktual. \$) ²	11 839	I 19-ti
AZZh Vendi	Po	N/A
AZZh si pjesë e të ardhurave kombëtare bruto (%) ³	4.29	I 80-ti
AZZh për kokë banori (\$ - çmimet aktuale) ³	187.04	I 80-ti


Financat e donatorëve gjatë strategjisë së fundit (m€)⁴



8.2. Burimet e mundshme të financimit përmes granteve

- Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP): Një platformë e përbashkët e BE-së, donatorëve bilateral, IFZh-ve/INF-ve si dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mbështetja përmes granteve për BT dhe bashkinvestim është në dispozicion për investime prioritare në transport, energji, mjedis dhe projekte zhvillimore të sektorit digjital, social dhe privat. Programi i BE-së për Lehtësimin e Garancive për Ballkanit Perëndimor mund t'i zbusë rreziqet si në investime si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.
- Përveç fondeve të kanalizuar përmes KIBP-së, në dispozicion mund të jetë e dhe Instrumenti kombëtar i BE-së për financimin e Para-Anëtarësimit (IPA). Fushat prioritare për Kosovën sipas IPA II përfshijnë infrastrukturën, qeverisjen, reformën ligjore, energjinë, politikat e punësimit dhe ato sociale, aftësinë konkurruese, zhvillimin bujqësor dhe rural dhe bashkëpunimin rajonal. IPA III do të fillojë të zbatohet në vitin 2021.
- Donatorët bilateral si Luksemburgu, Zvicra, Suedia dhe MB mund të sigurojnë fonde dhe mbështetje si partnerë në fushat e përzgjedhura prioritare.
- Fondi Special i Aksionarëve të Bankës mund t'i rregullojë mospërputhjet midis nevojave të paplotësuara dhe mbështetjes në dispozicion nga donatorët (posaçërisht në fushën e zbatimit të projekteve infrastrukturore, reformave të politikave dhe qeverisjes).

Përdorimi i granteve në 2018-19⁵



1. Rangim i thjeshtë i përqindjes që raportohet si pjesë e ekonomive të BERZH-it që përfaqësohen nën Kosovën. 2. Burimi: IZHB-të (2019 ose viti më i fundit)
3. Të dhënat për BT 2016-2019 bazohen në shënjestrat në nivel të projektit. Shumat e granteve për bashkinvestime bazohen në nënshkrimet e klientëve.
4. Bazuar në cilësinë e tranzicionit të granteve të destinuara (për grantet për BT) ose të nënshkruara me klientët (për grantet për bashkinvestime) në vitet 2018 dhe 2019.



Shtojcat

PUBLIC



European Bank
for Reconstruction and Development

Përkushtimi i Kosovës ndaj parimeve politike të përcaktuara në nenin 1 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës dhe zbatimi i tyre ka vazhduar që nga miratimi i strategjisë së mëparshme të vendit, në përputhje me përpjekjet e saj drejt zbatimit të agjendës së reformave gjithëpërfshirëse të BE-së. Shumë sfida mbesin në të njëjtën kohë. Kosova ka shumë dobësi kryesore institucionale të përbashkëta për vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto përqekësohen më tutje nga marrëdhëniet e ndërlikuara ndëretnike brenda vendit dhe kundërrthëniet e vazhdueshme politike në bashkësinë e gjerë ndërkombëtare përkitazi me statusin e Kosovës.

Kosova e ka shpallur pavarësinë në vitin 2008. Çështja e ligjshmërisë së këtij akti është shqyrtuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND-ja), së cilës ajo i ishte referuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (APKB-ja). GJND-ja e ka marrë vendimin e saj në 22 korrik të vitit 2010, duke vendosur që Deklarata e Pavarësisë "nuk e ka shkelur asnjë rregull të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare¹". Edhe pse ky vendim përbënte opinionin këshillëdhënës, i cili, si i tillë, nuk është i detyrueshëm për asnjë vend, ai u përforcua në shtator të vitit 2010 me Rezolutën e APKB-së, në të cilën u "pranua përmbajtja e vendimit të GJND-së". Përderisa shumë vende nuk e njohin Kosovën, dhe kjo do të mbetet çështje politike për të cilën duhet të vendosë secili shtet anëtar i bashkësisë ndërkombëtare, numri i njohjeve bilaterale e ka kaluar 100 nga viti 2021. Kundërrthëniet e vazhdueshme politike, që burojnë nga qëndrimet e ndryshme në bashkësinë ndërkombëtare më të gjerë lidhur me statusin e Kosovës, ndikojnë në vlerësimet e situatës në Kosovë që bëhen nga akterë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Korniza kushtetuese dhe legjislative për një demokraci parlamentare pluraliste, ndarja e pushteteve dhe kontrollet dhe ekuilibrat në sistemin politik, garancitë për të drejtat themelore dhe mbrojtjen e pakicave dhe për rolin kuptimplotë të shoqërisë civile ekzistojnë në Kosovë dhe janë kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Dobësitë kryesore të Kosovës, të cilat janë të përbashkëta për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshijnë sundimin e dobët të ligjit, kapacitetin relativisht të ulët të administratës publike, sidomos në nivelin lokal, dhe një kulturë të pabarabartë të dialogut dhe ndërtimit të konsensusit politik. Përparimi në këto fusha kanë qenë i ngadaltë.

Përpjekjet drejt përafrimit me BE-në mbeten spiranca kryesore e jashtme për reformat gjithëpërfshirëse. BE-ja e ka theksuar vazhdimisht se Kosova ka perspektivë evropiane të përbashkët me pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor. Kosova e ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në në tetor të vitit 2015. Ajo është aprovuar nga Parlamenti Evropian më 21 janar të vitit 2016 dhe ka hyrë zyrtarisht në fuqi më 1 prill të vitit 2016.

Kosova dhe Serbia janë përfshirë një dialog të ndërmjetësuar nga BE-ja që synon normalizimin e marrëdhënieve të tyre, i cili mbetet i rëndësishëm që të dyja të ecin përpara në rrugët e tyre drejt Evropës. Përkundër një numri të marrëveshjeve që janë lidhur si pjesë e këtij dialogu, deri më tani ka pasur pak përparim në zbatimin praktik të tyre. Për pjesën më të madhe të periudhës së strategjisë së mëparshme ka pasur, për arsye të ndryshme, një ngërç në nivelin më të lartë të dialogut.

Zgjedhjet e lira dhe qeveria përfaqësuese

Zgjedhjet e lira, të ndershme dhe konkurruese

Korniza ligjore ekzistuese, e cila bazohet kryesisht në dy ligje (Kushtetutën e vitit 2008 dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme që është miratuar në të njëjtin vit), mundëson zgjedhje demokratike, me kusht që autoritetet dhe partitë politike të shfaqin vullnet të mjaftueshëm për ta zbatuar atë. Që nga viti 2010, janë bërë disa përpjekje të pasuksesshme për ta ndryshuar sistemin zgjedhor, të cilat kanë dështuar për shkak të mungesës së konsensusit midis akterëve kryesorë.

Zgjedhjet në Kosovë zakonisht e mundësojnë konkurrencën midis partive të ndryshme politike dhe zgjedhjen e lirë për votuesit. Kandidatët janë në gjendje të bëjnë fushatë lirshëm. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) është organ i pavarur i përhershëm, që emërohet nga parlamenti për një mandat katërvjeçar dhe që funksionon në mënyrë efikase dhe transparente. Kodi Zgjedhor e parashihet vëzhgimin e zgjedhjeve vendore dhe ndërkombëtare në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.

Zgjedhjet e fundit të përgjithshme, të cilat u zhvilluan në shkurt të vitit 2021, ishin të pestat që nga shpallja e pavarësisë dhe të katërtat që u mbajtën në

1. Pajftueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën. Opinion Këshillëdhënës, GJND Raportet 2010.

mbarë vendin, përfshirë Kosovën veriore me shumicë të populluar nga serbët. Të gjitha këto zgjedhje kanë qenë të hershme. Pandemia e bëri të pamundur organizimin e një misioni të plotë të vëzhgimit të zgjedhjeve (MVZ) nga BE-ja si në të kaluarën, por pikëpamja e përbashkët e ekipeve zgjedhore të vendosura në terren ishte se zgjedhjet, dhe veçanërisht dita e zgjedhjeve, ishin të rregullta dhe paqësore, edhe pse disa çështje afatgjata mbeten. Në raportet e mëparshme të MVZ-së zgjedhjet janë vlerësuar si përgjithësisht të organizuara dhe administruara mirë, transparente dhe pa incidente apo shkelje të mëdha, me fushatë të gjallë dhe konkurruese, përveç zonave të Kosovës me shumicë serbe, ku ka mungesë konkurrence. Përderisa votimi zhvillohet mjaft mirë, besueshmëria e procesit paszgjedhor shpesh ndikohet negativisht nga mungesa e vendimeve në kohë nga KQZ-ja dhe nga trajtimi joefikas i ankesave dhe certifikimi i vuvar.

Ndër problemet e tjera afatgjata të zgjedhjeve kosovare është besueshmëria e listës së votuesve: e cila përmban më shumë votues se sa popullsia e vlerësuar rezidente e vendit. Një çështje tjetër për një kohë të gjatë janë procedurat për votimin jashtë vendit. Në raportet e mëparshme të MVZ-së është theksuar edhe tendenca për të thirrur zgjedhje të parakohshme përmes një njoftimi jashtëzakonisht të shkurtër dhe për ta shkurtuar fushatën zgjedhore zyrtare. Në raportet e MVZ-së si prioritet është rekomanduar përmirësimi i saktësisë së listës së votuesve, duke e dhënë një njoftim para së paku dy muajve për zgjedhjet dhe përfshirja e dispozitave të qarta për rezultatet sfiduese në të gjitha nivelet.²

Ndarja e pushteteve dhe kontrollet dhe ekuilibrat efektivë

Korniza kushtetuese dhe legjislative për një demokraci parlamentare pluraliste, e përforcuar me ndarjen e pushteteve dhe kontrollet dhe ekuilibrat në sistemin politik, legjislatura e pavarur dhe procedurat e mbikëqyrjes legjislative në fushat e përcaktuara të vendimmarrjes ekzistojnë në Kosovë dhe janë kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Gjykata Kushtetuese është e pavarur dhe po e luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Gjatë viteve të fundit, ajo i ka marrë një numër vendimesh me ndikim të fortë politik.

Parlamenti me një dhomë, i cili është institucioni kryesor legjislativ i zgjedhur drejtpërsëdrejti për një mandat katërvjeçar, është i përbërë nga 120 vende, përfshirë 20 vende të rezervuara për subjektet politike që i përfaqësojnë pakicat

etnike. Shtrirja e kompetencave të legjislativit për të kërkuar llogari nga qeveria dhe për të ushtruar mbikëqyrje parlamentare mbi të është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndonëse në praktikë mbikëqyrja e degës ekzekutive të pushtetit mbetet e dobët. Ka hapësirë për përmirësim në forcimin e mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura, autoriteteve dhe agjencive rregullative, me një mekanizëm të përshtatshëm të raportimit dhe llogaridhënies. Efikasiteti i përgjithshëm i punës së parlamentit ka nevojë për përmirësim, meqë minohet nga mungesa e shpeshtë e kuorumit dhe mungesa e dialogut politik konstruktiv.

Sfidat kryesore të tjera përfshijnë ekspertizën profesionale relativisht të dobët në nivelin lokal, kufizimet buxhetore dhe kapacitetin e përgjithshëm për absorbim.

Fuqia efektive për t'i qeverisur zyrtarët e zgjedhur

Kosova ka krijuar aranzhime institucionale, ligjore dhe financiare që zyrtarët e zgjedhur të ushtrjnë fuqi efektive për të qeverisur dhe për të mos qenë të kufizuar nga ndonjë kompetencë e vetos jodemokratike apo ndonjë ndikim tjetër i paligjshëm.

Kosova dallohet në rajon për shkak të pranisë së konsiderueshme ndërkombëtare, ndonëse kjo prani tani e luan një rol të kufizuar. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (RKS KB 1244), me të cilën është themeluar Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) në vitin 1999, është ende zyrtarisht në fuqi dhe shërben si bazë për praninë ndërkombëtare neutrale ndaj statusit si të UNMIK-ut, ashtu edhe të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX-it).

EULEX-i, i themeluar në vitin 2008, ishte misioni më i madh civil i lansuar ndonjëherë në kuadër të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Qëllimi i tij është që autoriteteve kosovare t'u ndihmojë në fushën e sundimit të ligjit, posaçërisht në polici, gjyqësor dhe dogana. Përgjegjësitë e EULEX-it, si dhe personeli i tij, janë zvogëluar gradualisht (nga më shumë se 3,000 në vitin 2008 në më pak se 500 në vitin 2020). Mandati i tij aktual skadon në qershor të vitit 2023. Kosova ka edhe prani të huaj ushtarake që udhëhiqet nga NATO - Forca e Kosovës (KFOR-i) - e cila, në përputhje me RKS KB 1244, e ka udhëhequr një operacion për mbështetje të paqes në Kosovë që nga qershori

2. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i BE-së. Zgjedhjet e parakohshme legjislative në Kosovë, 6 tetor 2019. Raporti përfundimtar.

i vitit 1999. Sot, një KFOR mjaft i zvogëluar (rreth 5,000 trupa) vazhdon t'i kontribuojë ruajtjes së një ambienti të sigurt dhe të siguruar dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët.

Shoqëria Civile, mediat dhe pjesëmarrja

Shkalla dhe pavarësia e shoqërisë civile

Ekziston një kornizë ligjore e kënaqshme për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të). Si kudo tjetër në Ballkanin Perëndimor, OSHC-të mbeten shumë të varura nga fondet e huaja, ndërsa problemet me financimin janë pengesa më e madhe për funksionimin e tyre. Shumë OSHC-ë janë të bazuara në projekte, dhe relativisht pak të specializuara. Megjithatë, ndryshe nga shumë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, OSHC-të në përgjithësi janë të përhapura në mënyrë të barabartë në mbarë vendin, përfshirë zonat rurale. Në prill të vitit 2019, Kuvendi e ka miratuar një Ligj të ri për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare, i cili e ka përmirësuar mbrojtjen ligjore për OSHC-të, duke e përshtatur atë me standardet më të mira ndërkombëtare. Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile për 2019-2023 është miratuar përmes një procesi përgjithësisht pjesëmarrës, me fokus në përmirësimin e pjesëmarrjes në OSHC-të të bazuara në komunitet dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të këtij sektori. Vlerësimi i zbatimit të strategjisë së mëparshme të vendit ka demonstruar njëfarë përparimi të arritur në fushën e konsultimeve publike dhe transparencës në financimin publik.

Në vitin 2018, një raport vjetor për konsultimet e qeverisë është publikuar për herë të parë. Konsultimet publike nga qeveritë po përmirësohen, përfshirë përmes një përdorimi të shtuar të konsultimeve online. Përdorimi i shumë organe publike kanë kryer për herë të parë thirrje dhe konsulta të hapura në përputhje me kërkesat ligjore, kapaciteti mbetet i pabarabartë.

Pavarësia dhe pluralizmi i mediave që veprojnë pa censurë

Pluralizmi në media që veprojnë kryesisht lirshëm dhe pa censurë dhe qasja në informata publike janë rritur gjatë viteve të fundit. Korniza ligjore ekziston përgjithësisht dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Mediat elektronike janë të rregulluara përmes akteve nënligjore të nxjerra nga organi

rregullativ audio-vizual, Komisioni i Pavarur për Media. Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës, i cili është organ vetërregullues për mediat e shkruara, ndihmon në promovimin e lirisë së fjalës, të drejtën e qytetarëve për t'u informuar siç duhet dhe respektimin e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Në të njëjtën kohë, duhet të bëhet më shumë për të siguruar që liria e shprehjes dhe mediave, që garantohen me Kushtetutë, të respektohen në praktikë, pasi që ekziston një perceptim i përhapur në mesin e qytetarëve kosovarë se mediat janë tejet të politizuara dhe nën presionin e partive politike. Strukturat e pronësisë së mediave mbeten të paqarta. Edhe pse mediat janë të obliguara të dorëzojnë raporte për pronësinë e tyre çdo vit, nëse nuk janë të regjistruara si kompani dhe nuk paguajnë taksa, ato nuk janë të detyruara t'ia tregojnë askujt pronësinë e tyre.

Burimet kryesore të informacionit janë televizioni, mediat online dhe rrjetet sociale, posaçërisht për popullatën mjaft të re të Kosovës. Transmetuesi publik (RTK-ja) i ka katër kanale dhe dy radio stacione. Janë pesë kanale televizive private, të cilat e tërheqin një audiencë të konsiderueshme. Gjatë viteve të fundit është dëshmuar një rritje shpërthyes në qasjen në internet, duke e bërë shkallën e depërtimit të internetit në Kosovë të krahasueshme me vendet e BE-së. Mediat sociale po e luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, ndërsa Facebook-u është platforma kryesore që përdoret nga kosovarët (pothuajse gjysma e popullsisë).

Kanalet e shumta të pjesëmarrjes qytetare dhe politike

Ka kanale të shumta të pjesëmarrjes civile dhe politike. Qeveria raporton çdo vit për zbatimin e dokumenteve kryesore strategjike të saj. E drejta për qasje në informatat publike është e rregulluar me ligj. Parlamenti i ka përmirësuar aktivitetet e tij të komunikimit gjatë disa viteve të fundit, përfshirë seancat publike. Qeveria e ka krijuar një mekanizëm për konsultimet me shoqërinë civile për projektligjet e reja.

Liria për të formuar parti politike dhe ekzistenca e opozitës së organizuar

Liria për të formuar parti politike garantohet me Kushtetutë dhe zbatohet praktikisht, siç dëshmohet nga ekzistenca e një opozite të konsiderueshme të

aftë për të bërë fushatë lirshëm dhe për t'i kundërshtuar nismat e qeverisë. 25 subjekte politike kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit të përgjithshme, ndërsa në parlamentin kombëtar përfaqësohen 14 parti politike të ndryshme.

Sundimi i ligjit dhe qasja në drejtësi

Epërsia e ligjit

Ka masa mbrojtëse legislative dhe institucionale të nevojshme për epërsinë e ligjit. Gjatë disa viteve të fundit, Kosova ka miratuar legjislacion për reformën kryesore gjyqësore, si dhe kornizën ligjore dhe institucionale thelbësore për të siguruar se ka sundim të ligjit. Qytetarët kanë të drejtë në gjykim të lirë dhe të drejtë dhe janë të lirë nga arrestimi apo ndalimi arbitrar. Autoritetet kosovare janë zotuar se do bashkëpunojnë me EULEX-in, duke përfshirë Task Forcën Speciale Hetuese, e cila i ka hetuar akuzat për krime lufte që janë ngritur përmes Rezolutës 1782 të APKE-së që është miratuar në janar të vitit 2011, dhe më vonë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës (DhS/ZPS të Kosovës). Në vitin 2020, Presidenti në detyrë i Kosovës, ish-Kryetari i parlamentit dhe lideri i një prej partive më të mëdha politike janë dorëzuar vullnetarisht në DhS/ZPS të Kosovës pas aktakuzës së konfirmuar kundër tyre. Të dy kanë dhënë dorëheqje nga funksionet shtetërore dhe politike të tyre. Më parë, në vitin 2019, një Kryeministër në detyrë i është përgjigjur thirrjes së DhS/ZPS të Kosovës për marrje në pyetje dhe ka dhënë dorëheqje rrjedhimisht.

Pavarësia e gjyqësorit

Pavarësia e gjyqësorit është e garantuar me Kushtetutë, ndërsa ekzistojnë masa mbrojtëse kryesore për të siguruar paanshmërinë e tij, edhe pse zbatimi është i pabarabartë. Forcimi i pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit ka qenë, sipas BE-së, diçka që i ndihmon Kosovës shumë në këtë fushë, njëri nga objektivat kryesore të reformave të vazhdueshme gjithëpërfshirëse. BE-ja ka vlerësuar se ka pasur përparim për këtë qëllim, kryesisht në fushën e reformave legislative në sferën e sundimit të ligjit. Megjithatë, gjyqësori mbetet i cënueshëm nga ndikimi politik i paligjshëm.³

Qeveria dhe qytetarët i nënshtrohen ligjit njësoj

E drejta për të pasur qasje në informata publike është e përcaktuar me ligj, ndërsa numri i kërkesave për të cilat është dhënë përgjigje apo të cilat janë refuzuar është relativisht i ulët. Kuvendi ka miratuar ligje për deklarimin e pasurisë dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Reformat fillestare në administratën publike krijojnë kushte për krijimin gradual të një shërbimi civil të qëndrueshëm dhe profesional, i cili duhet të jetë një rrugë e rëndësishme për ta parandaluar keqpërdorimin e detyrës dhe për të siguruar që qeveria dhe qytetarët të jenë të barabartë para ligjit. Reformat kanë përfshirë miratimin e një ligji për shërbimin civil, themelimin e Ombudspersonit (Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës) dhe miratimin e ligjit të ri për Ombudspersonin.

Politikat dhe institucionet efektive për të parandaluar korrupsionin

Korniza ligjore për luftën kundër korrupsionit është në fuqi dhe është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Edhe pse Kosova, për shkak të çështjeve të statusit që janë shpjeguar në preambulën e shtojcës 1, nuk është palë e konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit, ajo ka bërë përpjekje për ta harmonizuar legjislacionin e saj me këto konventa. Kodi Penal ri, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2019, i ka harmonizuar dispozitat e tij me praktikatat më të mira të BE-së.

Sa i përket organizimit, aktualisht ekzistojnë pothuajse njëzet institucione të ndryshme kundër korrupsionit në Kosovë. Bashkërendimi midis tyre është i dobët dhe ka dyzim të përgjegjësisë të tyre. Megjithatë, vendimi i qeverisë, në tetor të vitit 2020, për ta shfuqizuar njërin nga këto institucioneve, Task Forcën Speciale kundër Korrupsionit brenda policisë, është kritikuar nga BE-ja si minim i përkushtimit të autoriteteve për ta luftuar korrupsionin e nivelit të lartë.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (IPK) të Transparency International të vitit 2020, rangimi i Kosovës është përkeqësuar gjatë viteve të fundit, ndërsa ajo aktualisht është vendosur si e 104-ta nga 180 vende, në nivel të njëjtë me Shqipërinë. Në raportin e fundit të progresit të KE-së për Kosovën bëhet me dije se në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht korrupsionit të nivelit të lartë, është bërë përparim i kufizuar. Qëkur është themeluar, Agjencia kundër Korrupsionit prokurorisë ia ka dërguar më shumë se 1.000 raste.

3. Raporti Kosova 2020, Komisioni Evropian, 6 tetor 2020.

4. po aty

Që nga miratimi i strategjisë së mëparshme të vendit, më shumë se 60 raste që kanë të bëjnë me korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar i janë nënshtruar monitorimit nga mekanizmi i sapothemeluar për përcjelljen e të dhënave, por vetëm tetë kanë përfunduar me aktgjykime fajësuese. Situata në veri të Kosovës sa i përket krimit të organizuar vazhdon të paraqesë sfidë për agjencitë e zbatimit të ligjit.⁴ Këshilli i BE-së, në konkluzionet e tij të 18 qershorit të vitit 2019, e ka theksuar nevojën për ta "trajtuar me vendosmëri" korrupsionin dhe krimin e organizuar.⁵

Të drejtat civile dhe politike

Liria e fjalës, informimit, fesë, vetëdijes, lëvizjes, shoqërimit, tubimit dhe pronës private

Kosova ka bazë të ligjore qëndrueshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat janë përcaktuar në Kushtetutën e re të miratuar në vitin 2008. Kushtetuta i rendit aktet ndërkombëtare kryesore, përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj, të cilat janë të gjitha të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Kosovë dhe, në rast të mospërputhjeve, kanë përparësi ndaj ligjeve kombëtare. Ky është një mekanizëm i rëndësishëm, veçanërisht duke pasur parasysh se Kosova nuk është anëtare e OKB-së apo e Këshillit të Evropës me instrumentet e tyre të monitorimit dhe nuk është palë nënshkruese e ndonjë akti ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Kushtetuta ua ofron qytetarëve të drejtën për t'i dërguar shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me kushtetutë në Gjykatën Kushtetuese. Këtë mund ta bëjë edhe Ombudspersoni. Gjatë viteve të fundit, struktura të ndryshme shtesë janë krijuar si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal për të ndihmuar në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave themelore. Komuniteti ndërkombëtar vazhdon të jetë i përfshirë në ndërtimin e kapaciteteve në këtë fushë.

Meqë Kosova nuk është anëtare e OKB-së, ajo nuk është subjekt i vlerësimit në kuadër të Shqyrtimit Periodik Universal (proces ky përmes të cilit shqyrtohen, në mënyrë periodike, të dhënat për të drejtat e njeriut të Shteteve Anëtare të OKB-së). Grupi Punues Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut, i themeluar nga UNMIK-u në shtator të vitit 2015, ka ndihmuar në zbatimin e mekanizmave dhe kornizave për

të drejtat e njeriut nga ana e institucioneve përkatëse të Kosovës, përfshirë edhe rishikimin e draftit të Strategjisë së Kosovës për të Drejtat e Njeriut (2016-2020).⁶

Përdërisa institucionet shtetërore i zbatojnë dhe respektojnë të drejtat themelore në përgjithësi, raportet e fundit të BE-së i kanë vënë në pah mangësitë e tjera, përfshirë mungesën e mekanizmave bashkërendues për zbatimin efikas të strategjive për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Dobësitë në zbatimin konsistent të të drejtave të garantuara përfshijnë edhe fatin e pazgjidhur të personave të zhdukur pas konflikteve të viteve të nëntëdhjeta dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Përfshirja politike për gratë, etnitë dhe pakicat e tjera

Si rezultat i historisë së konfliktit ndëretnik të saj si dhe diferencave të vazhdueshme në opinion në bashkësinë ndërkombëtare më të gjerë lidhur me statusin e Kosovës, çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave etnike në Kosovë janë veçanërisht të ndjeshme. Në Kushtetutën e Kosovës në mënyrë specifike përmenden gjashtë komunitete etnike. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (të vitit 2011), shqiptarët etnikë përbëjnë 93 përqind e popullsisë; serbët etnikë 1.5 përqind; turqit etnikë 1 përqind; romët, ashkalitë dhe egjiptianët (RAE) 2 përqind; goranët 0,6 për qind; dhe boshnjakët 1.5 përqind. Duhet të theksohet, megjithatë, se serbët etnikë e kanë bojkotuar regjistrimin e vitit 2011 në veri të Kosovës, ndërsa pjesëmarrja e tyre në regjistrim në pjesët e tjera ka qenë e pabarabartë. Në vlerësimet jozyrtare që janë nxjerrë nga të dhënat që janë përdorur për qëllime praktike nga prania ndërkombëtare në Kosovë thuhet se serbët etnikë përbëjnë 5-7 përqind të gjithë popullsisë në Kosovë. Gjatë zgjedhjeve të përgjithshme në Serbi, administrata zgjedhore e përdor numrin prej afro 100,000 banorëve të Kosovës të regjistruar për të votuar në këto zgjedhje, por jo të gjithë janë domosdoshmërisht serbë etnikë.

Në Kosovë ka kornizë legislative për mbrojtjen e pakicave etnike. Të drejtat e tyre garantohen me Kushtetutë dhe me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është drejtpërsëdrejti e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi mbi legjislacionin e Kosovës.

5. Konkluzat e Këshillit, Procesi i Zgjerimit dhe Stabilizimit dhe Asociimit, Këshilli i Bashkimit Evropian, 18 qershor 2019.

6. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 1 shkurt 2016.

Interesat e komuniteteve etnike të pakicave mbrohen nga një mekanizëm i ndërlikuar në nivelin qendror.

Sipas standardeve rajonale, pakicat përfaqësohen mirë në parlamentin kombëtar dhe në qeveri. Në parlament janë 20 vende të ndara për pakicat nga 120 deputetë, nga të cilat 10 vende janë ndarë enkas për serbët etnikë. 20 vendet e "garantuara" janë të garantuara me Kushtetutë. Zgjedhjet e vitit 2014 kanë qenë të parat në të cilat sistemi i vendeve të "garantuara" e ka zëvendësuar sistemin e përkohshëm të vendeve "të rezervuara", të cilat pakicave në të kaluarën ua patën mundësuar që t'i kishin 25 deputetë, e jo 20 si në parlamentin aktual. Dy nga pesë nënkryetarët e parlamentit i përfaqësojnë komunitetet joshumicë.

Koalicioni aktual qeverisës përfshin shumicën dërrmuese të partive politike që i përfaqësojnë pakicat etnike, përfshirë serbët etnikë. Serbishtja është njëra nga dy gjuhët zyrtare në Kosovë, krahas shqipes. Janë bërë përpjekje për ta përmirësuar situatën në nivelin lokal, përfshirë përmes themelimit të komunave për t'i akomoduar veçanërisht interesat e pakicave etnike, duke përfshirë qasjen më të mirë në shërbimet themelore. Sot, nga gjithsej 38 komuna, dhjetë kanë popullsi serbe etnike ose të konsiderueshme, ose shumicë. Njëri nga elementet kryesore të marrëveshjes së ndërmjetësuar nga BE-ja të vitit 2013 midis Prishtinës dhe Beogradit për parimet për normalizimin e marrëdhënieve të tyre e ka paraparë krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe, temë e debateve të nxehta, përfshirë sa i përket dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës. KE pati rekomanduar, në mesin e masave specifike lidhur me të drejtat e njeriut, krijimin e një organi të veçantë që e mundëson konsultimin e drejtpërdrejtë me komunitetet pakicë për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Vazhdon të ketë mungesë të besimit midis shqiptarëve të Kosovës dhe disa prej komuniteteve pakicë të Kosovës. Agjenci të ndryshme raportojnë incidente të herëpashershme të motivuara nga urrejtja etnike dhe fetare dhe raste të diskriminimit, si dhe sulme fizike ndaj pakicave etnike. Autoriteteve do t'u duhet të bëjnë më shumë për ta siguruar integritetin e mirëfillt të pakicave etnike. Mbetet po ashtu që të bëhet më shumë për t'i mbrojtur pakicat më të vogla etnike, veçanërisht komunitetin RAE, që është më i cenueshmi. Janë ndërmarrë disa masa, veçanërisht për ta trajtuar çështjen e personave pa dokumente dhe për t'i integruar personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV-të) dhe refugjatët romë nga

Kosova. Projektet e edukimit kanë vazhduar të çojnë në njëfarë ngritjeje të shkallës së regjistrimit të fëmijëve romë në arsimin e mesëm. Megjithatë, ende ka shkallë të lartë të papunësisë, ndërsa qasja në beneficinet e papunësisë mbetet problematike. Stereotipizimi kundër RAE vazhdon, përfshirë edhe në media. Në Kosovë ekzistojnë elementet kryesore legislative për barazinë gjinore, përfshirë dispozitat kushtetuese dhe një ligj të veçantë për barazinë gjinore. Sipas standardeve rajonale, gratë kanë një përfaqësim mbresëlënës në parlamentin kombëtar, që e tejkalon 30 përqind. Që nga miratimi i strategjisë së mëparshme të vendit, dy presidente të Kosovës (duke e llogaritur presidenten aktuale) kanë qenë gra.

Megjithatë, në nivelin lokal gratë mbeten të papërfaqësuar sa duhet në shkallë të vendimarrjes. Nuk ka asnjë grua të vetme në mesin e kryetarëve të komunave në Kosovë. Ka po ashtu shumë pak gra nga pakicat etnike që kanë poste të larta politike. Zakonet dhe stereotipat diskriminues janë ende të pranishëm në zonat rurale, duke i cenuar të drejtat themelore të grave. Sipas të dhënave të OKB-së, 14 përqind e grave rurale janë analfabete, krahasuar me 4 përqind të burrave ruralë, që përbën një dallim të madh.

Liria nga ngacmimi, frikësimi dhe tortura

Ka garanci kushtetuese kundër ngacmimit, frikësimit dhe torturës, ndërsa ato mbështeten në praktikë. Përmes ndryshimit të Ligjit për Ombudspersonin, Kosova është harmonizuar me kërkesat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës. Një delegacion i Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitit apo Dënimeve Çnjerëzore apo Poshtëruese (KPT) për herë të fundit Kosovën e ka vizituar në vitin 2015. Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajtimit dhe kushteve të paraburgimit të personave në mbajtje nga policia dhe gjendjes në qendrat e shërbimit korrektues (përfshirë regjimin për shkelësit e mitur, të paraburgosurit dhe të burgosurit që mbahen në burgun e ri të sigurisë së lartë dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore). Sipas raportit të fundit të progresit të KE-së për Kosovën, gjendja mbetet "e kënaqshme".⁷